



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:041802

Datë: 23.05.2022

Numri i dokumentit: 03044451

**P.nr.998/18**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Rr.M me vendbanim në fshatin ... Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr.1166-5/18 e datës 17.07.2018 me kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në bazë të nenit 106 par. 1 nën par. 1.6 dhe nenit 107 par.1 dhe 8 të KPRK-ës, me datë 23 Maj 2022 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Hudhet** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr.1166-5/18 e datës 17.07.2018, e ngritur kundër të akuzuarit Rr.M me vendbanim në fshatin ... Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-ës dhe **Pushohet Procedura Penale** për shkak te parashkrimit absolut te ndjekjes penale.

Pala e dëmtuar – Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari me adresë në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarit Rr.M me vendbanim në fshatin .... Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr.1166-5/18 e datës 17.07.2018, pas pranimit të lëndës me datë 31 Korrik 2018 nga gjyqtari i cili ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë dhe pas pranimit nga gjyqtarja e kësaj çështje penale me datë 02 Nëntor 2020 dhe shikimit të shkresave të saj dhe pas ndërmerres së veprimeve procedurale ka konstatuar se për veprën penale për të cilën është ngarkuar i pandehuri ka arritur parashkrimin absolut i ndjekjes penale sipas dispozitave ligjore.

Në dispozitivin e aktakuzës është përshkruar hollësisht se i akuzuari: me datë 20 Maj 2018, rreth orës 15:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur “....” në Rajonin Ekonomiko Pyjor Nerodime – Jezerc, është takuar duke prerë 3 copë trungje të ahut të njomë, me diametër prej 36 - 24 cm, e të gjata boniteti III, me vëllim të përgjithshëm prej 2.87 metra kub e në vlerë prej 395,91 – drunjët kanë qenë të prerë me sharrë motorike dhe të transportuara me traktor IMT-39.

Sipas këtij dispozitivi rezulton se vepra penale pretendohet te jete kryer me datë 20 Maj 2018 dhe për veprën penale për të cilën është akuzuar i pandehuri me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është ngritur aktakuza parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 106 të KPPK-ës, i cili rregullon parashkrimin e ndjekjes penale, ku sipas paragrafit 1 nënpar. 1.6 të kësaj dispozite është paraparë që ndjekja penale për veprat penale të dënueshme deri në 1 (një) vit burgim, nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 (dy) vjet nga kryerja e veprës penale, (**parashkrimi relativ i ndjekjes penale**), ndërsa në bazë të nenit 107 par.1 dhe 8 të KPRK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet ne çdo rast kur te ketë kaluar dyfishi i kohës se afatit te parashkrimit (**parashkrimi absolut i ndjekjes penale**), çka rezulton se deri

me datën e këtij vendimi kanë kaluar mbi 4 (katër) vite nga koha e kryerjes së veprës penale dhe rrjedhimisht në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e saj.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e sipër cekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm Penal,**

**P.nr.998/18 i datës 23 Maj 2022**

**Praktikanti,**

Arton Cokli

**Gjyqtarja,**

Mimoza SHABANI

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ ditëve nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.